



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 20.01.2026
Numër Protokolli: 829/2026

A.nr.1946/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1946/2025, të datës 26.11.2025, të parashtruar nga ankuesi Xh.R nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*transferim sipas rristurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1946/2025, e datës 26.11.2025 e parashtruar nga ankuesi Xh.R.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.R.MBPZHR 95/2025 i datës 31.10.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi Xh.R (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 26.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R.MBPZHR 95/2025, të datës 31.10.2025 të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e saj për shkak të rristurimit të organit të punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZHR), ndërsa, kjo e fundit, më datë 04.12.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 24.12.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:8046/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.1946/2025 të datës 26.11.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7568/2025 të datës 26.11.2025 të ankuesit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:8046/2025 të datës 24.12.2025; Vendimin Nr.R.MBPZhR 95/2025, të datës 31.10.2025 të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Kopjen e ID së ankuses; Akt Emërimit të ankuesit të datës 23.11.2012; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës për ankuesin të viteve 2023/2023/2024; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.12.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 04.12.2025; Vendimin e datës 04.07.2025 të Drejtorit të DMZP-së; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë i Logjistikës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë për Financa”; E-mailin e datës 17.06.2025 dërguar nga J.R për F.M me korrespondencën e bashkangjitur; Diplomë Nr.01/14 e datës 13.01.2017; Shkresë e pagave/Thesari i Kosovës; Raporti përfundimtar i Komisionit të Ristrukturimit i datës 30.10.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtuara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuses është ***e pabazuar***, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit Nr.3519 të datës 23.11.2012 është i punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pozitën “Zyrtar i Lartë i Logjistikës” në kuadër Divizionit për Shërbime të përbashkëta/Departamenti i Shërbimeve Administrative.

Tutje, përmes Vendimit Nr.226/ 2025, të datës 05.03.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me ç’rast procesi i organizmit të MBPZHR, është pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse, ndryshim të klasave të pozitive, si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve të punës për pozita të caktuara. Bazuar në legjislacionin në fuqi, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër V.nr. 1478/2025, të datës 04.07.2025, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MBPZhR, ku ky i fundit, më datë 30.10.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MBPZhR.

Sipas Raportit përfundimtar Nr.3412 të datës 30.10.2025, të Komisioni i Ristrukturimit, në pjesën e titulluar “Bartësi i pozitës së ndryshuar dhe shuar sipas organogramit të ri”, nën numri rendor 104, ankuesi nga pozita “Zyrtar i Lartë i Logjistikës”-Klasa Profesional 1, , është rekomanduar të transferohet në pozitën “Zyrtar i Lartë Financiar”-Klasa Profesional 1, në kuadër të Divizionit për Buxhet dhe Financa, me arsyetimin se pozita të cilën e ka mbajtur ankuesi “Zyrtar i Lartë i Logjistikës” është ndryshuar, respektivisht sipas strukturës së re organizative tani më është pozita titullohet “Zyrtar për Logjistikë”, ashtu që i është ndryshuar edhe klasa, pra ka kaluar në Klasën Profesional 2.

Me qëllim të zbatimit të propozimi të Komisionit të Ristrukturimit, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 31.10.2025, ka nxjerr Vendim me Nr.R.MBPZhR 95/2025, me të cilin ankuesen e ka transferuar nga pozita “Zyrtar i Lartë i Logjistikës”-në pozitën “Zyrtar i Lartë për Financa”, kurse ankuesi ndaj këtij vendimi me datë 26.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon se në rrethanat e rastit konkret nuk është plotësuar parakushti ligjor për transferimin e tij, ngase sipas 66 të LZP-së, transferimi për shkak të ristrukturimit ndodh vetëm në rastin kur shuhet pozita ndërsa pozita që kam mbajtur me akt emërim, nuk është shuar dhe po ashtu ankuesja pretendon se në rastin e konkret me transferimin e saj është shkelur edhe Rregullorja Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Rregullorja Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, me arsyetimin se nuk janë marr parasysh kualifikimi dhe përvoja e punës përvoja e punës sipas kërkesave të pozitës përkatëse, si dhe i njëjti pretendon se po ashtu është shkelur nenin 64 dhe 65 i LZP-së, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tij ndërsa të të anuloi aktin e kontestuar.

Kolegji i Këshilli me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, fillimisht analizoi dhe mori për bazë kuadrit ligjor në fuqi nga neni 66 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës”.....* dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës, duke përfshirë edhe klasifikimin e pozitave përkatëse sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Kolegji po ashtu, analizoi edhe strukturën e re organizative të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të miratuar sipas Rregullores (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, ashtu që u konstatoi se pozitës “Zyrtar i Lartë për Logjistikë” të cilën ankuesi e ka mbajtur sipas aktit të emërimit i është ndryshuar emërtimi, ashtu që është bërë “Zyrtar i

Logjistikës” dhe pozita në fjalë me rregulloren e re është klasifikuar në Kategorinë Profesionale 2, dhe figuron në kuadër të Divizionit për Logjistikë dhe Arkivë.

Po ashtu, Kolegji mori përbazë edhe dispozitat e aplikuara nga Rregullorja Nr.06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Shtojca Nr.1/5: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën **Profesional 1**, ku përcaktohet se kërkesat e përgjithshme formale janë: “**Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)*. **Kërkesat specifike:** *Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase*. **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punë*”, ndërsa sipas përshkrimit të detyrave të punës dhe kriterëve të aprovuar për pozitën “Zyrtar i Lartë për Financa” kërkohet si në vijim: **Arsimi** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në drejtimet (Ekonomik, financa apo kontabilitet) dhe së paku dy (2) vite të përvojës së punës profesionale*”, ndërsa po ashtu edhe sipas Katalogut të Vendeve të Punës për pozitën në fjalë e evidentuar me shifër SHC-0385 është përcaktuar kualifikimi i njëjtë arsimor.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me përmbushjen e kriterëve të pozitës përkatëse, po ashtu ka analizuar edhe përshkrimin e detyrave të punës dhe kriterëve të pozitës të cilën e ka mbajtur sipas aktit të emërimit, “Zyrtar i lartë i logjistikës” dhe konstatoi se sipas formularit të përshkrimit të detyrave të punës dhe kriterëve të pozitës përkatëse, të cilën organi i punësimit e ka ofruar në cilësi të provës materiale përmes shkresës së datës 04.12.2025, është kërkuar si në vijim: “*Diplomë Universitare, Fakulteti Ekonomik, ose Bachelor i Ekonomikut si dhe tre (3) vite përvojë në profesion*”, ndërsa nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji konstatoi se ankuesi posedon Diplomën me Numër:01/17 të datës 13.01.2017 përmes së cilës konstatohet fakti se ankuesi me datë 28.06.2016 ka mbaruar studimet në Kolegji Biznesi në Programin Menaxhment dhe Ekonomiks, prandaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me mungesën e përmbushjes së kriterëve të pozitës në të cilën është transferuar, nuk është i bazuar, pasi që nga konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi në të dy pozitën, pra edhe në pozitën të cilën e ka mbajtur para transferimit “Zyrtar i Lartë i Logjistikës”, por edhe në pozitën në të cilën është transferuar “Zyrtar i Lartë për Financa” është kërkuar kualifikim i njëjtë arsimor, prandaj për aq kohë sa është kërkuar kualifikimi i njëjtë arsimor për pozitën përkatëse edhe përvoja profesionale llogaritet e fushës së njëjtë, pavarësisht faktit nëse pozitën e punës nuk kanë të njëjtin emërtim

Thënë si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe pas analizimit dhe marrjes për bazë të kuadrit ligjor në fuqi, Kolegji i Këshillit erdhi në konstatimin se organi i punësimit respektivisht Komisioni i Ristrukturimit ka zbatuar drejt dispozitat e aplikuara nga nenin 66 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “66.1 Nëse për shkak të shuarjes apo rristurimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.”, ngase pozita në fjalë është ndryshuar si dhe të njëjtës pozitë i është ndryshuar Klasa profesionale nga Profesional 1 në Profesional 2, gjegjësisht pozita prandaj në rrethanat e rastit konkret janë zbatuar drejt dispozitat e aplikuara nga neni 13 paragrafi 5, 6 dhe 7 të Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ndërlidhur me nenin 66 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “3. Në çdo rast shuarje apo rristurimi të institucionit krijohet komisioni i rristurimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit/it në një pozitë të

lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës.”, ngase ankuesi i plotëson kriteret e përcaktuara për pozitën në të cilën është transferuar “Zyrtar i Lartë për Financa”, sikurse u theksua edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit është refuzuar ndërsa akti i kontestuar është lënë në fuqi sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.1946/2025, datë 20/01/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Xh.R;
- Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (*Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore*), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së